

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit P.R., për shkak të veprës penale rrëmbimi nga neni 194 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, duke vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.160/2014 të datës 06.04.2017 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.271/2017 të datës 03.08.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur me 15.03.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit P.R., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.160/2014 të datës 06.04.2017 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.271/2017 të datës 03.08.2017.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.160/2014 të datës 06.04.2017, i dënuari P.R., është shpallur fajtor për veprën penale rrëmbimi nga neni 194 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe është dënuar, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, të cilin dënim do ta mbaj në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) € dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.271/2017 të datës 03.08.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.160/2014 të datës 06.04.2017, e ka vërtetuar.

## **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe plotësimi i saj**

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga i dënuari nuk janë përcaktuar bazat e kundërshtimit të aktgjykimeve, por vetëm se është përshkruar rrjedha e procedurës penale dhe pretendimet e tij, mirëpo kërkesa e deponuar është plotësuar me shtojcën e datës 17.11.2017, në të cilën ka theksuar se, arsyet e paraqitjes së kërkesës janë për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

## **Mendimi i Prokurorit të Shtetit**

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtresën e evidentuar KMLP.II.nr.197/2017 e datës 24.10.2017, ka propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

## **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë, i dënuari nuk thekson ndonjë dispozitë konkrete ligjore e cila është shkelur gjatë gjyqimit të çështjes së tij, por konsideron se procesi ndaj tij është tërësisht i manipuluar dhe atë së pari nga zyrtarët policor, nga prokurori i rastit e i cili manipulim ka vazhduar edhe gjatë seancave gjyqësore. Pretendon po ashtu në manipulim të dëshmitarëve, të cilët janë familjar të të dëmtuarës N.R., dhe atë nëna dhe babai i saj. I dënuari mohon në tërësi kryerjen e kësaj vepre penale duke theksuar se në atë kohë ka qenë në restorantin e dëshmitarit R.R., i cili edhe ka dëshmuar në shqyrtimin gjyqësor.

Pas dorëzimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, i dënuari me datë 17.11.2017, ka deponuar shtojcë plotësuese me anë të së cilës po ashtu ka pretenduar për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh mbrojtjen e tij, meqë nuk e ka kryer këtë veprë penale dhe nuk ka pasur asnjë provë të qëndrueshme që e mbështetë fajësinë e tij. Nuk është

bërë vlerësimi dhe sqarimi i provave në shqyrtimin gjyqësor, se aktgjykimi nuk është marrë menjëherë pas përfundimit të seancës kryesore e me këtë nuk është publikuar, por është marrë dhe përpiluar më vonë, kurse kopja i është dorëzuar më vonë, me udhëzimin që në afat prej tri ditësh mund të ushtrohet ankesë.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme**

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e të dënuarit, janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa dhe shtojca e saj, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës penale dhe nuk qëndron pretendimi i të dënuarit se procesi gjyqësor, ka qenë i manipuluar, por përkundrazi fillimisht rasti ndaj të dënuarit është iniciuar nga e dëmtuara N.R., me datë 29.03.2014 në ora 23:30 dhe atë menjëherë pas ngjarjes, ashtu që e dëmtuara ka paraqitur rastin e tentimit të rrëmbimit duke identifikuar të dënuarin me të cilin një kohë kishin bashkëjetuar. Të dënuarit i është dhënë mundësia që të paraqes dhe argumentoj mbrojtjen e tij në secilën fazë të procedurës penale, duke filluar nga deklarimi i tij te policët hetues e i cili deklarim është bërë në prezencë të mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare av.F.N. Po ashtu edhe gjatë dëgjimit në cilësinë e të pandehurit në Prokurorinë Themelore në Gjilan, të dënuarit i është siguruar mbrojtës sipas detyrës zyrtare av. N.N..

Të dënuarit, i është siguruar mbrojtës sipas detyrës zyrtare, që nga dëgjimi i parë e pastaj edhe gjatë procedurës hetimore dhe shqyrtimit gjyqësor, i cili fakt konstatohet përmes procesverbaleve të marrjes në pyetje gjatë procedurës hetimore dhe procesverbaleve të shqyrtimeve gjyqësore, ku shihet se i dënuari dhe mbrojtësi i tij ishin pjesë aktive e procesit gjyqësor duke bërë pyetje dëshmitarëve dhe duke propozuar dëshmitar e gjithashtu të dënuarit i është dhënë mundësia që të paraqes mbrojtjen e tij pa asnjë pengesë, andaj, përmes kësaj mund të konstatohet se në të gjitha fazat e procedurës penale të dënuarit i është siguruar

një proces i drejtë, i rregullt dhe i paanshëm bazuar në dispozitat e KPPK-së dhe standardet e përcaktuara sipas KEDLNj.

Është i saktë pretendimi se në cilësinë e dëshmitarëve ishin familjarët e të dëmtuarës dhe atë babai dhe nëna e saj, por duhet theksuar faktin se dëshmitar të tjerë nuk kishte prezent kur kishte ndodhur ngjarja. Mbrojtësit dhe të dënuarit iu dha mundësia që të ju bëjnë pyetje edhe këtyre dëshmitarëve e për më tepër ia dha mundësia e propozimit të dëshmitarëve, të cilën të drejtë e shfrytëzuan, duke propozuar dëshmitarin R.R., për të prezantuar “alibin” se i dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në restorantin “Italia” në fshatin Ll., pronë e dëshmitarit R.R.. Kurse ky pretendim i të dënuarit nuk është argumentuar pasi që dëshmitari i cili sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 16.01.2016, ka dëshmuar se “...për datën kritike 14.03.2014, mua më kujtohet se Përparimi ka qenë në restorantin tim...” e që kjo dëshmi nuk kishte relevancë, pasi sipas dispozitivit të aktgjyqimit, vepra penale nga i dënuari rezulton se është kryer me datë 29.03.2014.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e vet, ka vlerësuar dhe arsyetuar dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve dhe për këto dëshmi ka dhënë arsytetime të qarta për secilën dëshmi veç e veç dhe duke i ndërlidhur dëshmitë njëra-tjetrën dhe njëkohësisht duke trajtuar edhe mbrojtjen e të dënuarit, e si rezultat i kësaj ka ardhur në përfundim se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale rrëmbimi në tentativë nga neni 194 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Pretendimet e paraqitura në shtojcën e kërkesës, po ashtu nuk qëndrojnë meqë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar mbrojtjen e të dënuarit duke dhënë arsye të qarta se pse nuk i ka besuar mbrojtjes së të dënuarit, por iu ka besuar dëshmimeve të dëshmitarëve N.R., B.R. dhe I.R., të cilët janë dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Me këtë gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në tërësi veprën penale me të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pos mbrojtjes së të dënuarit i cili vazhdimisht ka mohuar kryerjen e veprës penale.

Nuk është i bazuar as pretendimi se aktgjykimi, nuk është marrë menjëherë pas përfundimit të seancës kryesore sepse sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 05.04.2017, është konstatuar se shqyrtimit gjyqësor ka përfunduar në ora 16:05 minuta dhe palët prezentë i dënuari dhe mbrojtësi i tij kanë qenë të njoftuar se shpallja e aktgjyqimit do të bëhet me datë 06.04.2017 në ora 11:30, e që vërteton faktin se i dënuari ka qenë i njoftuar për datën dhe kohën e shpalljes së aktgjyqimit, të cilën e konfirmon edhe përmes nënshkrimit të tij në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Është i saktë pohimi i të dënuarit se aktgjykimi është përpiluar më vonë, pasi që nga shpallja deri te përpilimi i aktgjyqimit në formë të shkruar nevojitet afat i arsyeshëm e cili është respektuar nga ana e gjykatës së shkallës së

parë pasi që aktgjykimi është shpallë me datë 06.04.2017, është ekspeduar me datë 03.05.2017, kurse i dënuari e ka pranuar me datë 10.05.2017.

Gjithashtu nuk qëndron fakti se në aktgjykim është dhënë udhëzimi për ankesë në afat prej tri ditësh, pasi që në pjesën e fundit të aktgjykimit të shkallës së parë është cekur këshilla juridike se *“Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate”*.

Në kërkesë, i dënuari pretendon për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, mirëpo këto pretendime nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkeljen e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.245/2017, më datë 14.03.2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Valdete Daka